



Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional
"ABDYL RAMAJ"
Shirokë, Suharekë - Republika e Kosovës



Nr. Protokolli: 101-2026 Datë: 09.03.2026

Në bazë të Nenit 11 të UA, - Aktivitetet jashtëshkollore Nr. 02/2016, IAAP "Abdyl Ramaj" në Shirokë, bënë:

FTESE PËR OFERTË NR. 01/2026

Drejtoria e shkollës dhe Këshilli Drejtues i Shkollës vendosën për organizimin e Projektit shkollor "Ekskursioni i maturantëve, 2026", prandaj ftojmë OE e kualifikuar të ofertojnë mbështetur në kriteret:

- ☐ Sipas Planit Vjetor të Shkollës dhe rekomandimeve të KDSH-së, Ekskursioni i maturantëve planifikohet të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë, me preferencë në resurset e kompleksit hotelier "Bonita" në Durrës apo të kapaciteteve analoge apo më të larta.
- ☐ Periudha kohore e përshtashme për ekskursion është në dhjetë ditëshin e fundit të muajit prill. Kohëzgjatja e ekskursionit është 4 bujtje/5 ditë, me pansion të plotë;
- ☐ Në ekskursion do të marrin pjesë afërsisht 170 nxënës dhe kujdestaret e klasave
- ☐ Në ofertë të përfshihet: çmimi i akomodimit, ushqimit (mëngjesi+dreka+darka), transporti dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në muze dhe ambiente tjera kulturo historike të përcaktuara në Agjendën e ekskursionit të përgatitur nga Këshilli Drejtues i Shkollës.

OE që marrin pjesë në ftesën për ofertë, për Projektin shkollor "Ekskursioni i maturantëve Maj/2026" duhet të i plotësojnë këto parakushte dhe ta dëshmojnë me këto dokumente:

1. Leja e punës dhe licenca për transport të organizuar të udhëtimeve jashtë shteti; Certifikata e biznesit, Certifikata e TVSH-së;
2. Dëshmi të kontrollit teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore, fotokopje të dokumentacioni për të gjithë autobusët që do të përdoren në ekskursion. Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e ekskursionit dhe kapacitete të zëvendësimit të autobusëve në rast nevojë për kohë optimale;
4. Licenca "D" për drejtuesit e autobusëve, Fotokopje e noterizuar;
5. Certifikata e Kompetencës Profesionale - CPC për shëndetin fizik dhe mendor të drejtuesve të autobusëve dhe përcjellësve të angazhuar në ekskursion;
6. OE të sigurojë përkujdesjes mjekësore, për pjesëmarrësit në ekskursion gjatë kohëzgjatjes së tij. Të ofrohet leja e punës së mjekut, marrëveshja kontraktuale me mjekun (fotokopje);
7. OE të ofrojë dëshmi për rezervimin e hapësirave hoteliere për shkollën tonë, për datat: 20-24 prill 2026 ose 27 prill deri 1 maj 2026.
8. Hapësirat e akomodimit të ofrojnë ambiente komode sistemimi, ambiente të sigurta qëndrimi për aktivitete rekreative dhe të ofrojë shërbimin e sigurimit fizik profesional;
9. OE të ofrojë dëshmi për menunë e plotë ditore gjatë ditëve të qëndrimit në hotel;
10. Licenca e akreditimit të ushqimeve dhe ambienteve tjera rekreative për vendqëndrimin e nxënësve.
11. Afati i konkurrimit 7 ditë pune nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
12. Formulari i paraqitjes së Ofertës dhe Itinerari i ekskursionit merret në IAAP "Abdyl Ramaj" në Shirokë prej datës: 11.03.2026, gjatë orarit të punës.
13. Dorëzimi i ofertave bëhet deri më datë **18.03.2026 në ora 14:00** në zyrën pritëse të Komunës për DKA për IAAP "Abdyl Ramaj" në Shirokë;

Adresa: IAAP "Abdyl Ramaj" Zona Industriale, Shirokë -Suharekë
Tel.: +383 (0) 49 184 575; email: abdylramaj.shmp@gmail.com



13. Dorëzimi i ofertave bëhet deri më datë **18.03.2026 në ora 14:00** në zyrën pritëse të Komunës për DKA për IAAP "Abdyl Ramaj" në Shirokë;
14. Hapja e ofertave bëhet me datë 18.03.2026 në ora 15:00 në Sallën e Bordit të drejtorëve në Suharekë.
15. OE ofertat e tyre të mbyllura në Formularin për ofertim shënojnë çmimin ofertues

Kushtet tjera:

- Në rast të vizitave eventuale në qytete më të largët, të sigurohet racioni me ushqim të thatë;
- Hoteli të sigurojë ambient rekreativ, sallë për mbledhje muzikore;
- OE i nënshtrohet Agjendes së përgatitur dhe vizitave të monumenetev kulturo historike;
- Pavarësisht numrit të nxënësve, kujdestarët e klasave dhe përcjellësit e domosdoshëm nuk janë të detyruar të paguajnë për akomodim dhe transport.

Hapja dhe vlerësimi i ofertave

- ☐ Dokumentet jashtë afatit të paraparë për ofertë nuk pranohen;
- ☐ Dosjet e Operatorëve Ekonomik të pa kompletuara nuk shqyrtohen;
- ☐ Kriter kryesor për përzgjedhjen e OE do të jetë oferta më e përshtatshme
- ☐ Çmimi ofertues për nxënë;
- ☐ Kategoria e hotelit dhe kushtet e akomodimit numri i nxenesave në dhomë)
- ☐ Kualiteti i menysë;
- ☐ Referencat për natyrën e njejtë të aktivitetit;

Hapja e Formularit Ofertues do të organizohet në ambientet e DKA-së në prani të OE.

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, OE fitues ~~do të~~ shpallet në Tabelën e shpalljeve të Komunës dhe në faqen zyrtare të komunës.

Suharekë, më ~~18~~ 09.03.2026



Drejtori i shkollës: Destan Berisha